



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 17 shtator 2019

Komunikatë për media

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i, deri me sot ka pranuar 9 (nëntë) apele dhe 1 (një) ankesë.

Dy (2) Apelet e pranuar kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së, për emërimin e anëtarëve të KKZ-ve (Një (1) apel i paraqitur nga SP. Partia Liberale e Egjiptiane) dhe (Një (1) apel i paraqitur nga SP. Samostalna Liberalna Stranka). Të dy apelet janë hedhur si të palejuara.

Gjashtë (6) Apelet e pranuar kanë të bëjnë me kundërshtimin e vendimeve të KQZ-së për certifikimin e listës së kandidateve për deputet, respektivisht kërkesën për tërheqjen nga lista e kandidateve për deputet të subjekteve politike (Katër (4) apele i ka paraqitur SP. Partia Euroatlantike e Kosovës /PEK), (Një (1) apele ka paraqitur SP. Fjala) dhe (Një (1) apele e ka paraqitur SP. ESDAK).

Pesë (5) apele janë pranuar nga PZAP-i si të bazuara, që do të thotë se, kandidatet janë de certifikuar, tërhequr nga lista. Ndërsa një (1) apel është tërhequr që do të thotë se, kandidati ka pranuar të mbetet në listë edhe përkundër apelit për tu tërhequr.

Një (1) apel e ka paraqitur Lista Serbe, kundër Udhëzimit të KQZ-së Nr.965/2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 09.09.2019, për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ) dhe Këshillat e Vendvotimeve (KVV), për identifikimin e votuesve në vendvotime për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 6 tetor 2019. Apeli është refuzuar nga PZAP-i. Kundër këtij Vendimi të PZAP-it, SP Lista Serbe ka paraqitur ankesën ndaj vendimit të PZAP-it në Gjykatën Supreme dhe e ka refuzuar ankesën e këtij subjekti politik që do të thotë se është vërtetuar Vendimi i PZAP-it.

Një (1) ankesë e ka paraqitur Partia Kosvskih Serba, kundër bërjes së fushatës zgjedhore të parakohshme nga ana e Listës Serbe. Ankesa është hedhur si e palejuar.

Për me shume informata për të gjitha Vendimet e PZAP-it, lidhur me apelet dhe ankesat e paraqitura në PZAP deri me tani, ju lutem referojuni ueb faqes së PZAP-it